



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 17, datë 05.04.2024

**PËR**

**MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT DHE RISHIKIMIT TË KUSHTEVE GJATË  
NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “INFRASTRUKTURA E LIDHJES ME RRJETIN  
ELEKTRIK TË PARKUT FOTOVOLTAIK “BLUE 1”, ME VENDNDODHJE NË  
BASHKINË FIER**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shtyrjes së afatit dhe rishikimit të kushteve gjatë ndërtimit për objektin: “Infrastruktura e lidhjes me rrjetin elektrik të parkut fotovoltaik “Blue 1”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 22, datë 17.03.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Parku fotovoltaik Blue 1”, “Parku fotovoltaik Blue 2” dhe “Infrastruktura e lidhjes me rrjetin elektrik”, me vendndodhje në Bashkinë Fier.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave vetëm për “Infrastrukturën e linjës me rrjetin elektrik” bashkëlidhur Vendimit Nr. 22, datë 17.03.2021 “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Parku fotovoltaik Blue 1”, “Parku fotovoltaik Blue 2” dhe “Infrastruktura e lidhjes me rrjetin elektrik”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij vendimi.



3. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**





MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 02/04/2025